

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË MUJORE | GUSHT 2005 | Nr. 3

Ne e dimë nga përvoja e hidhur se shtypësi kurrë nuk ta ndanë lirinë vullnetarisht. Ajo duhet të kërkohet nga të shtypurit.

Martin Luter King

DEKLARATA PËR DHËNIEN E PAVARËSISË VENDEVE DHE POPUJVE TË KOLONIZUAR

Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme, numër 1514 (XV), me datën 14 dhjetor, 1960

Asambleja e Përgjithshme,

E *vetëdijshme* se popujt e botës, në Kartën e Kombeve të Bashkuara, janë deklaruar fuqishëm për të shpallur të vendosur sërish besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore, në barazinë e të drejtave të burave e grave, si dhe të kombeve të mëdha e të vogla, për të përkrahur përparimin shoqëror e për të krijuar kushte sa më të mira jetese në një liri më të madhe,

E *ndërgjegjshme* në nevojën për të krijuar kushte stabiliteti e mirëqenieje dhe marrëdhënie paqësore e miqësore të bazuara në respektimin e parimeve të barazisë së të drejtave dhe të vetëvendosjes së lirë të mbarë popujve, dhe për të siguruar respektimin e përgjithshëm e të vërtetë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe e feje,

Duke *njohur* dëshirën e pasionuar për liri të të gjithë popujve të varur dhe rolin vendimtar të këtyre popujve në rrugën për pavarësi,

E *vetëdijshme* për konfliktet në rritje që sjell mospranimi apo pengesat që ushtrohen ndaj lirisë së këtyre popujve, gjë që përbën një kërcënim të rrezikshëm për paqen botërore,

Duke *vlerësuar* rolin e rëndësishëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara si mjet për të ndihmuar lëvizjen për pavarësi në territoret nën kujdestari dhe në territoret jo autonome,

Duke *njohur* faktin se popujt e botës dëshirojnë fuqimisht t'i japin fund kolonializmit në të gjitha format e tij,

E *bindur* se vazhdimi i ekzistimit të kolonializmit pengon zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar, dëmton zhvillimin social, kulturor e ekonomik të popujve të varur dhe bie ndesh me idealin e Kombeve të Bashkuara për paqe botërore,

Duke *pohuar* se popujt, për qëllimet e tyre, mund të disponojnë lirisht me pasuritë dhe burimet natyrore që kanë, pa prekur detyrimet që rrjedhin nga bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, i mbështetur në parimet e përfutur reciprok dhe të së drejtës ndërkombëtare,

E *bindur* se procesi i çlirimit është i pandalshëm dhe i pakthyeshëm dhe se, për të shmangur krizat e mëdha, i duhet dhënë fund kolonializmit dhe tërë praktikave daluese e diskriminuese që e shoqërojnë,

Duke *shprehur* kënaqësinë për faktin se një numër i madh territoresh të varura kanë hyrë në rrugën e lirisë e të pavarësisë gjatë viteve të fundit, dhe duke njohur tendencat gjithnjë e më të forta për liri, të shfaqura në territoret që ende nuk gëzojnë pavarësinë e tyre,

E *bindur* se të gjithë popujt kanë të drejtë të pajtësueshme për të gëzuar liri të plotë, për të ushtruar sovranitetin e tyre



Foto: Rrezeant Galica - Gjiq

dhe për të ruajtur integritetin e territorit të tyre kombëtar,

Shpall solemnisht domosdoshmërinë për t'i dhënë fund me shpejtësi dhe pa kushte kolonializmit në të gjitha format dhe shfaqjet e tij;

Në synim të kësaj,

Deklaron se:

1. Nënshtrimi i popujve ndaj një robërie, dominimi dhe shfrytëzimi i huaj përbën mohim të të drejtave themelore të njeriut, e kjo është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe komprometon kauzën e paqes e të bashkëpunimit në shkallë botërore.
2. Të gjithë popujt kanë të drejtën të vendosin lirisht fatin e tyre; në bazë të kësaj të drejte, ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror e kulturor.
3. Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë.
4. Do t'i jepet fund çdo veprimi të armatosur dhe çdo mase shtypëse, e çfarëdo natyre qoftë ajo, drejtuar kundër popujve të

varur, me qëllim që t'u lejohej këtyre popujve të ushtrojnë në mënyrë paqësore e lirisht të drejtën që kanë për pavarësi të plotë, dhe do të respektohet integriteti i territorit të tyre kombëtar.

5. Në territoret nën kujdestari, në territoret jo autonome dhe në të gjitha territoret e tjera që ende nuk e kanë arritur pavarësinë e tyre duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për t'ua bartur popujve të këtyre territoreve të gjitha pushtetet, pa asnjë kusht e rezervë, në përputhje me vullnetin e dëshirat e tyre të shprehura lirisht, pa asnjë dallim race, besimi apo ngjyre, me qëllim që të mund të gëzojnë pavarësi të plotë.

6. Çdo përpjekje që synon të shkatërrojë pjesërisht apo tërësisht bashkimin kombëtar dhe integritetin territorial të një vendi është e papajtueshme me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

7. Të gjitha shtetet duhet të respektojnë me besnikëri e përpikmëri dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe të kësaj Deklarate mbi bazën e barazisë, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve e të respektimit të të drejtave sovrane dhe të integritetit territorial të të gjithë popujve.

Editorial

Serbia nuk mjaftohet me Kosovën si dikur. Ajo do që ta rimarrë Kosovën, mirëpo që kjo të mos jetë unike në kuptimin e territorit; që Kosova si autonomi në kuadër të Unionit SMZ të jetë e ndarë me kufij të brendshëm, që do të shënonin autonominë territoriale të serbëve në Kosovë. Dhe, kësaj radhe, në aspiratat e saj hegjemoniste, Serbia nuk dëshiron të konfrontohet me organizmat dhe institucionet ndërkombëtare ashtu siç i ngjante Milosheviqit. Për Serbinë procesi i decentralizimit është më i rëndësishëm edhe se ai i (fillimit të) negociatave. Decentralizimi do të shkaktojë legalizimin dhe zyrtarizimin e strukturave të Serbisë në Kosovë, por për më shumë se kaq, do të krijojë kufij të rinj të njësive të reja territoriale dhe administrative. Kundërshtimet e nganjëhershme të Serbisë për decentralizimin janë mënyrë për ngritjen e pazarit, e që kryesisht ka të bëjë me zgjerimin e kufijve të këtyre njësive të reja drejt fshatrave shqiptare, të cilat do të ishin pakicë aty. Ankesat për ngathtësinë e realizimit të decentralizimit s'janë veçse presion për përshpejtimin e tij.

Decentralizimi parashihet që të implementohet para negociatave ose edhe gjatë tyre. Fillimi i negociatave ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për statusin e Kosovës e garanton formulën "më shumë se autonomi, më pak se pavarësi". Rezultati i negociatave nuk mund të jetë qëndrimi fillestar i njërës palë. Pra, nuk ka pavarësi me negociata. Me negociata ka më pak se pavarësi. Pikërisht ky është qëllimi i Serbisë: ajo nuk do asgjë më shumë sa i përket statusit të Kosovës përveçse ta pamundësojë pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës. Dhe pastaj, diskutimi për statusin e Kosovës të zëvendësohet me diskutimin për statusin e autonomisë territoriale të serbëve në Kosovë. Decentralizimi është mënyra drejt autonomisë territoriale të serbëve të Kosovës, e cila s'bëhet as për t'i shërbyer serbëve të Kosovës, por për t'i kënaqur apetitet e Beogradit. Decentralizimi nuk është assesimi për pavarësinë e Kosovës, por edhe një tjetër mjet për parandalimin e saj. Pikërisht për këtë arsye i gjithë ky insistim që decentralizimi t'i paraprijë statusit. Decentralizimi s'ka të bëjë me interesat e qytetarëve, por me projektet politike. Ai do të shoqërohet me eksteritorialitetin që do t'u jepet kishave dhe manastireve serbe gjë që po bëhet përmes urdhërësave të PSSP-së.

Deri më tani janë përcaktuar pesë pilot komuna, dy prej të cilave janë me popullatë serbe. Njëra në Kosovën qendrore (Graçanica), e tjetra në lindje (Parteshi). Kjo e dyta meqenëse ndodhen në kufi me Serbinë është posaçërisht e rrezikshme. Pse nuk parashihet decentralizimi në komunat në veri të Kosovës? Shumë thjesht: veriun e Kosovës, Serbia tashmë e konsideron si pjesë të saj. Për Serbinë Kosova fillon nën lumin Ibër.

Ne, aktivistët e VETËVENDOSJE!-s, kemi filluar të shkojmë nëpër fshatrat dhe vendbanimet që drejt-përsëdrejti do të ndikohen nga procesi i decentralizimit. Bisedojmë me njerëzit atje dhe u ndihmojmë të organizohen kundër decentralizimit dhe strukturave të reja administrative, që do t'i sjellë implementimi i tij. Sikurse pothuajse për çdo gjë tjetër në Kosovë, as për decentralizim nuk ka mundësi për ndryshime institucionale. Ka mbetur vetëm populli që ta ndalë të keqen që e lansoi Serbia, e lejoi dhe imponoi UNMIK-u, ndër-sa IPVQ-të e pranuan pa rezervë.

Albin Kurti

Florini

Glauk Konjufca

Florini s'e njoh as e kam parë kurrë. Ndoshta edhe e kam parë, s'e di... s'është fort me rëndësi. E tëra që di është emri dhe mosha e tij. Ai ka 33 vjet. Nejse. E rëndësishme dhe po aq e tmerrshme është çka ka thënë dhe ç'mendon ai. Më rastisi që në numrin e pestë të një gazete informuese, të cilën e nxjerr OSBE-ja, me titull 'Detaje' (fq. 3), ta lexoj një shkrim për procesin e decentralizimit. Florini ishte njëri nga ata qytetarë të rastit, i cili po i përgjigjej pyetjes, që i kishte bërë gazetarja e atij shkrimi, Zana Limani. Në pyetjen e saj se ç'mendon për decentralizimin, Florini përgjigjet:

Unë kam votuar në zgjedhje dhe kam dhënë votën time për të zgjedhur këto institucione, kështu që besoj se ato bëjnë gjithçka që është në mundësinë e tyre për të zgjidhur problemet tona. Nëse ata mendojnë se decentralizimi është ajo çfarë na duhet, atëherë unë e përkrah.

A mund të gjendet vallë ndonjë shembull më ilustrativ për shpjegimin e të gjitha problemeve nëpër të cilat po kalon sot Kosova? Florini është mikrokozma e krejt asaj që po ndodh në vendin tonë. Le të fillojmë me qesëndi dekonstruktivin e kuptimit të mendimit të tij. Ai ka dalë në zgjedhje. Mendon që një gjë e tillë është 'obligim qytetar'. Ai nuk e di dallimin ndërmjet të drejtës dhe obligimit. Aq i bën. Pas përfundimit të luftës, ai u kthye në Kosovë. Para luftës, si shumë qytetarë shqiptarë, Florini ishte keqtrajtuar nga një polic serb. Ai Florini i kishte pas rënë shuplakë. Serbia për të ishte armiku ashtu sikur për të gjithë popullin e tij. Kur ushtria dhe policia serbe e përzunë dhunshëm nga Kosova, shpresat e tij kishin veç një emër: NATO. Këtë të fundit e konsideronte mik të popullit të tij. Dhe, sikur një vegim i kujtohej ajo thënia që i kishte treguar gjyshi kur Florini ishte i vogël: 'armiku i armikut tënd është miku yt'. Ëndrra e tij u realizua. Ai s'mund të besonte: në vendlindjen e tij nuk po i zinte syri asnjë polic apo ushtar serb. U gëzua pa masë. Të mos shohësh më tankse rrugëve, të mund të bërtasësh ç'të duash - paj, ç'kuptim tjetër mund të ketë liria? Dhe Florini mendoi: ne ia dolëm. Falë Zotit, NATO-s dhe miqve tanë. Ai ishte fort i bindur që Bill Clintoni, Papa Gjon Pali II (tashmë i ndjerë), Jacques Chiracu dhe Joscha Fisherit e sollën pavarësinë e Kosovës. Duhet vetëm edhe njohja formale, dhe gjithçka do të jetë në rregull. Sepse, ne de facto jemi të pavarur... Me l'u kthyer në Kosovë, Florini ishte dëshmitar i zhvillimit të shumë proceseve demokratike shtetformuese: populli i tij u bë me qeveri, parlament, polici, ushtri, televizion publik, objekte universitare... Mbi të gjitha, jetën shoqërore e gjallëronte pluralizmi politik. Partitë shumta politike garonin lirshëm për të fituar përkrahësit e tyre. Zgjedhjet ishin një satisfaksion i veçantë për të. Votën e shihte si fetish: shkop magjik për zgjidhjen e problemeve. Florini mezi që u punësua. Kishte fat që

daja i tij qëlloi të jetë zëvendësministër. Megjithatë, të ardhurat e tij mujore si nëpunës i rangut të ulët, ia sigurojnë, në mos diçka tjetër më shumë, atëherë, mbijetesën gjithsesi. Zgjedhjet e fundit ishin hera e katërt që Florini po votonte. Në kërkën e tij, proceset politike kishin veç një kuptim: mjafton të besosh në mençurinë dhe vizionin e një politikani, prandaj t'ia japësh atij votën, dhe kjo është mënyra më efektive se si delegohet interesi i qytetarit për t'u mbrojtur nga një forcë e caktuar politike. Florini besonte në IPVQ-të e Kosovës, vetëm ngaqë ishin të Kosovës dhe vetëm pse quheshin 'institucione'. Ndoshta edhe ngaqë punonte aty... Florini i besonte UNMIK-ut, ngaqë, siç shpesh e përsëriste, pa ndihmën e tyre ai nuk do të mund të kthehej në Kosovë. Prandaj, si rrjedhim i kësaj ndihme, mirësia e tyre nuk mund të vihej në pikëpyetje. Njëjtë e mirë duhet të jetë edhe agjenda e tyre politike: standardet para statusit dhe decentralizimi. Edhe politikanët, të cilëve ai ua kishte dhënë votën, do të duhej të ishin të mirë. Paj, po të mos ishin të mirë dhe të zotë, ata nuk do të ishin aty ku janë! Kjo është arsyeja pse ata po i përkrah edhe UNMIK-u, miqtë tanë ndërkombëtarë. Ata na e duan të mirën. Dhe do të na e sjellin pavarësinë e plotë në vitin 2006... Njëjtë mendoi ai edhe në vitin 2002, 2003, 2004 dhe sivjet poashtu. Sidoqoftë, 'pavarësia është proces...' Dhe, kështu Florini vazhdon jetën e tij të thjeshtë. Por, ai tashmë nuk është vetëm njëri. Florini është dukuri, ai është bërë vetëdije. Problemet e Kosovës qëndrojnë në përpjestim me numrin e 'Florinëve'. Kosova, bile, është problem i Florinit. Definimi i problemit të Florinit është identifikimi apriorik i mirësisë dhe mençurisë së individit me pozicionin politik të tij. Bazamenti i këtij identifikimi është iracional: Florini BESON që politikanët ia duan të mirën vendit; që ata 'dijne', sepse janë NE 'pushtet'; që unë 'duhet' të votoj; që zgjedhjet 'zgjidhin' problemet... që kjo është 'demokracia'. A s'është Florini paradigma ideale e atij 'materiali' të përshtatshëm që nëpërmjet të ndërimit të iluzionit të demokracisë t'i shërbejë UNMIK-ut si legjitimitet formal për implementimin e agjendës së tij në shpërputhje me interesat më fundamentale të këtij populli? IPVQ-të janë konkretizimi i këtij legjitimiteti formal të UNMIK-ut. Këto institucione janë ndër-tuar nga një 'material'. Ai quhet Florin. Dhe, kështu shtyhen përpara të ashtuquajturat 'procese demokratike' në Kosovë. Një projekt i dëmshëm, siç është decentralizimi, vjen nga 'lart'. UNMIK-u merr përsipër ta zbatojë atë. IPVQ-të janë të krijuara që ta pranojnë pa kushte dhe ta tumirin formalisht atë. Ndërkaq, Florini është për të votuar këto institucione mjerane. Ky është tregimi se qysh krijohet panorama 'idilike' e demokracisë iluzore në vendin tonë. Krejt këtë pafytyrësi, pjesëtarët e këtij inxhinieringu iluzionkrijues e quajnë 'progres', në një kohë kur vetëm dy gjëra janë rritur në vendin tonë: pasurimi kriminal i shumëllojshëm i qytetarëve...

Decentralizimi

Populli nuk ka pushtet për të decentralizuar. UNMIK-u ka pushtet për ta demonopolizuar. Decentralizimi nuk po bëhet për t'u integruar në Evropë, por për t'u integruar në Serbi. Decentralizimi pa sovranitet është ndarje. Decentralizimi në Kosovë do të shërbejë që Serbia, e cila instrumentalizon minoritetin serb, ta përforcojë pushtetin në enklava pasi që ka kompaktësi në to. Në Kosovën e enklavizuar, decentralizimi është e kundërta e multietnicitetit. Decentralizimi do t'i betonojë ndarjet etnike ekzistuese duke i bërë ato legalisht territoriale dhe institucionale. Franca ende nuk e ka përfunduar procesin e decentralizimit!!! Përmes decentralizimit, Serbia synon kantonizim dhe autonomi territoriale për serbët e Kosovës. Nëse përmes

është në komunën e Skënderajt dhe kufizohet me fshatin Runik. Runiku aktualisht ka afërsisht 350 shtëpi dhe është bashkësi lokale e 12 fshatrave, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë komunë. Tash shtrohet pyetja: pse duhet që fshati Bajë me afërsisht 50 shtëpi të bëhet komunë, e jo Runiku që i plotëson të gjitha parakushtet për një gjë të tillë?! Përgjigja është shumë e thjeshtë: Banorët e fshatit Bajë janë që të gjithë serbë, me përjashtim të katër shtëpive shqiptare në këtë fshat. Për më tepër, fshatrat rreth Bajës (si për shembull Dreth, Jakubë, Ceropolë, Cerkozë, Suhogërlë - pjesa që është në komunën e Skënderajt) janë të banuara me serbë dhe kanë lidhje territoriale me veriun e Kosovës, e ky është një indikator domethënës se përmes

3, Pilot-Projektet, gjegjësisht 3.1, Definimi i pilot-projekteve, paragrafi 11 thotë: "Pilot njësitë komunale do të nisin me të njëjtat kompetenca, si edhe komunat tjera ekzistuese, që i kanë sipas ligjit të aplikueshëm". Ruajtja apo ndryshimi i kufijve ekzistues të komunave është kompetencë e PSSP-së dhe, po ashtu, përgjegjësi e PSSP-së është për të siguruar se sistemi i administratës komunale lokale do të funksionojë në mënyrë efektive, duke u bazuar në parimet e njohura dhe të pranuar në arenën ndërkombëtare. Sipas planit të qeverisë, ndër kriteret kryesore të përcaktuara për krijimin e pilot projekteve për komuna, përfshihen: "numri i banorëve, tiparet gjeografike, infrastruktura në dispozicion, qëndrueshmëria ekonomike, tradita kulturore dhe gjuhësore". Në një vend të vogël si Kosova dhe me një popullsi relativisht të vogël në numër, mbështetja në kriterin e traditës kulturore dhe gjuhësore s'është tjetër veçse marrje për bazë e aspektit etnik në ndarjen e re territoriale. Pra, qëllimi është të krijohet komuna të reja të pastra etnikisht. Në anën tjetër, ndër kompetencat e shumta që parashihen të barten tek komunat e reja që do të krijohen me projektin për decentralizim, përfshihen edhe zhvillimi ekonomik, kujdesi shëndetësor, regjistrimi dhe dokumentacioni civil, shërbimet e arsimit fillor dhe të mesëm etj. Decentralizimi në Kosovë është tepër i ngutshëm, aspak i domosdoshëm për rrethanat, i rrezikshëm për të ardhmen, si dhe tepër i kushtueshëm për buxhetin e Kosovës. Sipas përllogaritjeve paraprake, vetëm faza e parë e implementimit të planit për decentralizim, e që pritet të fillojë shumë shpejt, pritet t'i kushtojë buxhetit të Kosovës rreth 7 milionë euro. Pra, Qeveria e Kosovës fare pa problem pranon t'i hyjë një ekperimentimi siç është plani për krijimin e pilot njësite të reja komunale, pa analizuar paraprakisht koston e këtij eksperimenti të rrezikshëm, duke mos analizuar mirë rrethanat në të cilat ndodhet vendi, mundësitë teknike dhe politike, dhe shumë gjëra të tjera të domosdoshme për t'u llogaritur para çdo ndërmarrjeje. Me një fjalë, Qeveria e Kosovës me ato pak mjete që ka buxheti i Kosovës, po investon në ndarjen e vendit, duke i krijuar Serbisë një përparësi shumë të madhe në momentin kur të vendoset për statusin politik të Kosovës. Qeveria këmbëngulë vazhdimisht se nuk do të ketë decentralizim në baza etnike dhe se pilotprojektet do të përfshijnë vetëm një zonë kadastrale, derisa urdhëresa administrative mbi implementimin e pilotprojekteve, e nënshkruar nga PSSP-ja disa ditë më parë, parasheh që "pilotnjësitë mund të përfshijnë një ose më shumë zona kadastrale". Një vendim i tillë është në përputhje me kërkesat e Serbisë që pilotnjësitë e reja të përfshijnë më shumë fshatra dhe vendbanime serbe përreth. Kësisoj, në rastin e Graçanicës, serbët këmbëngulin që në komunën e re të përfshihen edhe vendbanimet me shumicë serbe të Çagllavicës, Preocit dhe Kishnicës.



decentralizimit Serbia nuk arrin ndarjen klasike të Kosovës, atëherë, ajo të paktën synon palestinizimin e vendit tonë. Qëndrimet e pushtetit në Serbi janë të njëjta me ato të Milosheviqit: ky i fundit kërkonte vetëvendosje vetëm për serbët e Kroacisë dhe Bosnjës, por jo për shqiptarët në Kosovë, as për hungarezët në Vojvodinë dhe myslimanët e Sanxhakut. Njëjtë edhe për decentralizimin: ata e duan decentralizimin në Kosovë, por jo në Serbi. Pas 17 marsit 2004, Qeveria e Serbisë ka kërkuar nga UNMIK-u që të filloj procesin decentralizimit. UNMIK-u e ka pranuar kërkesën e Qeverisë së Serbisë. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Bajram Rexhepi, me 17 korrik 2004 ka nënshkruar Dokumentin Kornizë, të cilit dokument i referohet Programi i punës për 2005 - "Reforma e qeverisë lokale" i Ministrisë për Administratë e Qeverisjeje Lokale, i publikuar në shkurt të vitit 2005. Decentralizimi është ofertë, në radhë të parë, për komunitetin serb. Këtë më së miri e dëshmon fakti se nga dhjetë njësi komunale që parashihet të krijohen - tani po fillon implementimi i vetëm pesë pilotnjësive komunale - gjashtë prej tyre janë serbe: Graçanica (Prishtinë), Parteshi (Gjilan), Gorazhdeci (Pejë), Osojani (Istog), Binça (Klinë) dhe Baja (Skënderaj). Dy njësi komunale janë për minoritetet tjera. Dy për shqiptarët. Përveç fshatrave tjera, fshati Bajë është shembulli që e ilustron më së miri se përmes këtij procesi po synohet ndarja etnoterritoriale e Kosovës. Fshati Bajë, siç u tha edhe më sipër,

Bazat e mosorganizimit politik

Besnik Pula

Dikur na ishte një kohë kur angazhimi politik kërkonte hartimin e traktateve dhe librave të tërë vetëm për të argumentuar të metat dhe gabimet e qëndrimeve të rivalëve apo edhe të bashkëpartiakeve. Ishte kjo një kohë kur parimet kishin domethënie, qëndrimi kishte konsekuencë dhe qasja sistematike ndaj dinamikës politike kishte vlerë parësore jo vetëm intelektuale, por edhe strategjike. Sa e largët duket tash ajo kohë, kur kontestet midis dhe përbrenda fraksioneve politike bëhen jo për pozicionime konkrete, elaborimet teorike e ideologjike, mbi vlerën e synimeve dhe qëllimeve politike e shoqërore, mbi strategji e taktika, mbi forma organizative e mbi aktivizimin e domosdoshëm, por për numra rreshtor në lista zgjedhore dhe për kontestet mbi kontrollin e ministrive. Ky është maksimumi i diapazonit politik sot, është fillimi dhe fundi i horizontit politik kosovar. Lufta jo e parimeve dhe pikëpamjeve, por e egove dhe personaliteteve është niveli në të cilin ka degjeneruar politika kosovare. Por pse të jetë ndryshe? Politika, në veçanti ajo që legjitimohet nga elektorati, nuk është diçka që lundron mbi shoqërinë, nuk është fushë e izoluar ku grupet e ndryshme bëjnë lojë për vete, por një refleksion, një pasqyrë (sado e shtrembëruar) e konflikteve që zhvillohen brenda shoqërisë, vlerave dhe synimeve që përfaqësojnë atë shoqëri. Kur afirmimi i personalitetit, kulti i personit dhe simbolit apo imazhit që ai përfaqëson, dhe jo i një ideje apo qëndrimi të artikulluar, ngritet në vlerën më të lartë shoqërore, politika do ta reflektojë këtë me një besnikëri të pasqyrore. E sa i përket politikës së sotme, ajo njeh vetëm një parim: konformizmin. Ajo mbetet konformiste edhe kur kundërshton. Konformizmi nuk do të thotë të mos

kundërshtosh, por ta kërcësh vallen sipas muzikës së tjetërkujt, edhe kur shkon në anën e kundërt. Qe gjashtë vite në Kosovë luhet vallja e tjetërkujt, e kjo klasë politike e ndjek pas me hapat e pasigurt të diletantit, atij që nga shkaku që nuk e din vallen mundohet ta imitojë tjetrin, e del qesharak para të gjithëve. Kur Filani (cilido emër i huaj bën këtu) thotë "standardet" - politikanët bertasin, nuk na pelqejnë, nuk dimë çka janë tamam, por do t'i ndjekim gjithsesi, t'i pëmbushim deri në pikën e fundit! Kur ai thotë "Kosova multietnike" - politikanët gjegjen, nuk reagojmë kur i digjen shtëpitë plakave serbe, por Kosovën multietnike do ta bëjmë se s'bën ndryshe! Është kjo rezultat i një politike që drejtohet, elaborohet dhe zhvillohet nga një klasë e njerëzve të dominuar, e njerëzve që nuk mund të dalin nga gropa e vetëhapur e inferioritetit dhe nënshtrimit të vet. Është kjo një situatë që e përshkruan me përpikmëri një fjali e Rousseau-s: "Ata që veten e konsiderojnë sundimtarë të të tjerëve, janë skllëvër më të mëdhej se sa të sunduarit".

"Rob i shpisë" në shtëpinë tënde

Dhe në fund kjo nuk është çështje personash e personalitetesh, nuk është çështje se kush kujt çfarë i tha, kush kujt çfarë i bëri, cili që burrë i ndershëm e cili i pandershëm. Nuk është çështje garniturash e nomenklaturash -- asnjë sistem politik, asnjë kulturë politike nuk mbështetet në kaq. Është çështje shumë më e thellë. Është çështje vlerash, synimesh, e vetëdijes kolektive, është çështje forme e punësh, është çështje arritjesh e rezultatesh. Edhe kjo qeveri ekzistuese, sikur qeveria që shkoj, operon jo me një mandat politik, por me mandat diplomatik. Mandati diplomatik i saj nuk rrjedh nga arsyeja se

ajo ndikohet nga Peterseni apo Solana, por për shkak se ajo, sikur qeveria e parë, po ndjek një agjendë të papërcaktuar për Kosovën, jo nga nevojat e shumta të shoqërisë kosovare, por nga nevojat e diplomacisë perëndimore. Një qeveri që ndjek një projekt shoqëror është një qeveri me mandat politik. Ajo qeveri ka mandat që të bëjë ndryshime, që ta çojë shoqërinë në një kahje të caktuar. Kjo qeveri - lënë mënjanë ambiciet personale të pjesëtarëve të saj - ka mandat diplomatik, që ta çojë Kosovën atje ku e duan të tjerët, e që në fund nuk do të jetë mirë as për diplomatët as për Kosovën. Siç e pohojnë edhe vetë protagonistët e qeverisë, prioritet i saj kryesor është pëmbushja e standardeve. Standardet janë pjesë e një dokumenti diplomatik, e nevojave për Kosovën ashtu siç shihen ato nga Solana dhe nga ministratë e jashtme të Parisit, Berlinit e Washingtonit. Ato nuk janë diçka e negociuar, e arritur me marrëveshje, por diçka e imponuar, e bërë për nevojat e tjetërkujt, qofshin ato edhe nevojat më banale burokratike të një nënsekretari diku në Londër, i ngarkuar me "monitorimin e gjendjes së të drejtave të minoriteteve në Kosovë". Por kjo nuk është veçse një vazhdimësi e parimit politik që është vendosur në Kosovë nga viti 1999, kur në Kosovë shkeli këmba e Bernard Kouchner-it -- që "ndërkombëtarëve" (një kategori mistifikuese, por me efekte të fuqishme politike) duhet t'u rrihet kokëulur dhe galitit, dhe se kjo është rruga që do të çojë në pavarësi. Kjo është "strategjia" gjashtëvjeçare e burrave tanë të mëdhej të kombit. Kjo është logjika e njerëzve të dominuar -- edhe ata që ishin të gatshëm t'ia kthenin pushkën uniformës serbe, nuk janë të gatshëm t'ia kthenin fjalën apo t'i thonë "jo" kahjeve që UNMIK-u, OSBE-ja, Zyra Amerikane apo kushdo tjetër do ta çojë Kosovën. Mos të

harrojmë se sot Kosova ka 2500 hektarë më pak si rezultat i kësaj politike, se Mitrovica është akoma e ndarë, se Kosova është vendi me shkallën e papunësisë më të madhe në Evropë, dhe se lufta e shqiptarëve në sytë e botës po merr karakterin e një aktiviteti kriminal, siç na përkujton çdo ditë Haga. Dominimi, "mendja e robëruar" siç quhet nga disa, nuk është natyra e mendimeve që ka një njeri i robëruar. Por është mënyra se si ai mendon që e bëjnë atë të robëruar. Robin nuk duhet mbajtur lidhur me pranga, ai vetë të qëndron galitit. Sepse, në fund, ai nuk është rob i tjetërkujt, por i vetvetes. Robëruesi nuk është robëruar, sepse dallohet nga ndonjë atribut i veçantë (sepse është i madh, i fortë etj.), por sepse i robëruari i nënshtrohet atij, ia falë besnikërinë pa kushte dhe e quan "zotit im". Kjo është natyra e raporteve që politika kosovare ka me administratën ndërkombëtare. Administrata ndërkombëtare dhe aparati diplomatik që e mbështet, nuk dominon sepse është e fortë, e madhe, e gjithdijshme. Ajo dominon sepse politikanët tanë i vetë-nënshtrohen asaj, sillen ndaj saj me servilitet. Dhe kur dikush sillt ndaj teje si servil, nuk ke zgjidhje tjetër pos të sillesh si i zoti i tij. Serviliti imponon të jesh sundimtar, të jesh i zoti i tij. Politika kosovare ia imponoi administratës ndërkombëtare të sillt si i zoti, sepse ndaj saj ata, kolektivisht dhe pa dallime individuale, u treguan servilë të dorës së parë. "Ju lutem na jepni kompetenca" thonë, "kompetenca" që UNMIK-u nuk i shpikë me shkop magjik po që të njëjtit këta që kërkojnë kompetenca ia dhuruan UNMIK-ut para gjashtë vitesh! Por ky servilitet nuk do të kishte edhe dimensione qesharake nëse nuk do të behesh në emër të ca "aleancave" dhe "miqësive të përhershme" që Kosova paska me Amerikën, Gjermaninë,

Francën, Italinë, Papën e të tjerët. Gjithsesi, vasali nuk është aleat, e puthadorasi nuk është mik i askujt. Nuk është fjala as për aleanca as për miqësi, por për një mungesë boshti kurriroz në atë që quhet politikë në Kosovë. Është simptomë e një kulture që nuk ka dalë nga dallgët e mentalitetit të nënshtrimit, e një klase njerëzish që nuk dinë të jetojnë pa dikë që qëndron mbi ta, që ia orienton jetën dhe bindjet politike (qoftë edhe në kuptimin negativ si kundërshtar) - qoftë ai serbi i djeshëm, qoftë figura e sotme e "ndërkombëtarit". E një kulture që nuk di çfarë do të thotë të jesh i zoti i fatit tënd, dhe që gjithmonë pret nga tjetri që t'ia rrefejë fatin. Thjesht, është pasojë e një lëvizjeje politike (dhe këtu përfshihen të gjithë, LDK, UÇK dhe gjithë të tjerët në mes) që deshi të çlirohet, por jo të emancipohet. Kjo e përkufizon historinë aktuale të Kosovës, një shoqëri e "çliuruar" nga "shkau", i ashtuquajtur "armik shekullor", por e pa emancipuar nga inferioriteti që ia ka krijuar vetvetes. Një kulturë që vazhdon, diku në një botë paralele, të konsumojë një histori, që do ta bëjë simbas qejfit, të thurrë mite e legjenda për vetveten dhe heroizmat e veta mbihistorike, e ta mohojë faktin se ishte VIKTIMË E DHUNUAR e jo hero, që ajo që e identifikon është mjerimi i Bilacës dhe jo trimëria në fushëbetëje, vaji i femrës së dhunuar dhe jo shtatllartësia e ushtarit trim, që është një bastard i historisë së re dhe jo përçuese e vlerave nga lashtësia. Kjo kulturë që mistifikon me shumë se që sheshon, që fsheh nga vetja ato që duhet treguar gjithkujt, që e mohon historinë të cilën e jeton, është rob i një realiteti të zhveshur historik - faktit që Kosova nuk është, nuk është e lirë.

KOMENT

NATO-SMZ, Urdhëresa Administrative dhe 1.000 ushtarët britanikë

Shkëlzen Gashi

I. Me 18 korrik, në Beograd është nënshkruar dokumenti "Në mbështetje të paqes në Ballkan" mes autoriteteve të SMZ-së dhe NATO-s. Dokumenti është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Shefer dhe Ministri i Jashtëm i SMZ-së, Vuk Drashkoviç. Ky dokument nënkupton trupim të papengesë dhe të papagesë të trupave të NATO-s, pajisjeve dhe mallërave, materialit, armëve, municionit, eksplozivit, automjeteve, helikopterëve dhe avionëve të NATO-s nëpër territorin e SMZ-së. Natyrisht që edhe në këtë dokument thuhet se do të respektohet sovraniteti i SMZ-së, sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Marrëveshja e nënshkruar në Beograd është në përputhje të plotë me kapitullin e 7-të të Marrëveshjes së Rambujesë. Në Kapitullin 7 të Marrëveshjes së Rambujesë - Shtojcat - Shtojca B: Statusi i forcave implementuese multinacionale, pika 8, garanton që "personeli i NATO-s do të gëzojë së bashku me automjetet, aeroplanët, mbajtësit dhe mjetet e tij, qarkullim të lirë,

të pakufizuar dhe hyrje të papenguar nëpër tërë RFJ-në, duke përfshirë hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale". Për këtë arsye është bërë intervenimi i NATO-s. Gjashtë vjet më vonë, po realizohet pothuajse plotësisht qëllimi i intervenimit të NATO-s në ish-Jugosllavi.

II. Me 21 korrik 2005, PSSP-ja, Soren Jensen Petersen, ka nënshkruar urdhëresën administrative 2005/11 për jetësimin e decentralizimit. Këtë urdhëresë ai e ka nënshkruar pas konsultimeve me Qeverinë e Kosovës. Por, edhe sikur Qeveria ta kundërshtonte këtë urdhëresë, ajo do të nënshkruhej nga PSSP-ja dhe do të fillonte zbatimin i saj. Decentralizimi është legalizim i enklavizimit ekzistues. Për fat të keq, përveç decentralizimit, paralelisht është duke ngjarë edhe një proces tjetër tepër i dëmshëm dhe që i kontribuon ndarjes së Kosovës: njohja e statusit eksterritorial për disa kisha dhe manastire serbe. Përmes urdhëresës administrative 2005/5 Manastiri Ortodoks Serb në Deçan është përcaktuar si zonë speciale. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me Graçanicën,



Foto: Rezeart Galica - Gjiç

Patriarkanën e Pejës dhe Kishën e Deviqit.

III. Është shumë domethënëse paralajmërimi se Britania e Madhe do të dërgojë 1.000 ushtarë në Kosovë, ngase kur të fillojnë negociatat për statusin përfundimtar është shumë i gjasshëm shpërthimi i konfliktit. Konflikti do të shpërthejë, sepse rezultati i negociatave do të jetë një doku-

ment që do ta ketë si parim pacënueshmërinë e integritetit dhe sovranitetit territorial të Unionit Serbi-Mali i Zi. Pra, si rezultat i negociatave do të kemi një dokument, që do të jetë në kundërshtim me vullnetin e popullit. Se ky dokument do të jetë në kundërshtim me vullnetin e popullit e pat thënë edhe nënsekretari amerikan i shtetit, Nicholas Burns, në fjalimin e tij nëntëfaqësh në Kongresin Amerikan,

ku ndër të tjera pat thënë se kufijtë shtetëror në Ballkan nuk do të ndryshojnë. Mosndryshimi i kufijve shtetëror në Ballkan do të thotë shkelje e vullnetit të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Edhe OKB është kundër ndryshimit të kufijve shtetëror në Ballkan dhe konsideron se zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 1244.

Shkruaj këto parulla:

Deri në vetëvendosje

Refuzo nënshtrimin. Ballafaqohu.

I thuaj JO këtij pushteti. Jo vetëm sot.
Përgjithmonë.

Liri, barazi, drejtësi

Liberté, Égalité, Fraternité
226 vjet më vonë!

Populli është zgjidhja

UNMIK, the worst that one can get

UNMIKOLONIALIZËM

YUNMIK

Standards = Racism



Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrihen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

Kroi i Bardhë, nr. 76
Lagja Dardania
Prishtinë, Kosovë

038 541411
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!**

Graphic & design: Rrezeart Galica - Giqi

Sovraniteti

11. Mungesa e sovranitetit është mungesë e shtetësisë. Prandaj ne nuk jemi qytetarë, por vetëm banorë. Dokumentet tona të udhëtimit lëshohen nga UNMIK-u. Ato nuk njihen nga shumë shtete anembanë botës. Si rrjedhim, ne jemi të kufizuar në nevojën themelore njerëzore për të qarkulluar. Ne nuk mund të shfrytëzojmë lirshëm mundësitë e lidhjes me botën. Kjo bëhet për ta izoluar vendin tonë.

12. Meqë populli në Kosovë nuk është sovran, ai është i privuar drejtpërdrejt nga mundësia e mirëmenaxhimit të pasurive të tij natyrore. Trepça, p.sh., ka mbetur peng i një vendimi që s'është yni. Kjo do të thotë që populli i Kosovës nuk mund t'i gëzojë përfitimet e shfrytëzimit të pasurive të tij.

13. Fondi Pensional i Kosovës qëndron jashtë Kosovës, sepse vendi ynë nuk kontrollon pasurinë e qytetarëve të tij. Ne nuk mund të kemi institucione qendrore bankare, prandaj nuk mund të shfrytëzojmë të gjitha beneficionet që do të vinin po që se pasuritë tona do të qarkullonin brenda vendit tonë.

14. Politikat fiskale kontrollohen nga UNMIK-u dhe kjo nënkupton domosdoshmërinë që ne t'i përshtatemi politikave ekonomike të Bankës Botërore, ndërkohë që nuk mund të përfitojmë asgjë, sepse na mungon sovraniteti (shteti). Përveç kësaj, ne duke mos mundur të vendosim për politikën tatimore, kemi ardhur në situatën ku prodhuesit vendorë nuk kanë leverdinë e iniciativave për prodhime vendore.

15. Mungesa e subjektivitetit politik, pra, e sovranitetit, është mungesë e mekanizmave për ruajtjen e tërësisë territoriale. Meqë ne nuk kemi sovranitetin, tjetërkush bën marrëveshje për tokën tonë. Tjetërkush i vë kufijtë e vendit tonë. Marrja e 2500 hektarëve tokë të Kosovës nga Maqedonia, marrëveshje të cilën e bëri kjo e fundit dhe Unioni SMZ, e për të cilën nuk na pyeti askush, nuk mund të shpjegohet ndryshe përpos si pasojë e mungesës së sovranitetit.

(Vijon në numrin e ardhshëm)